



Udhëzues për Kreditë e Sindikuara

Letër këshilluese

Dhjetor
2024

Qëllimi

Prezantimi i sindikimit të kredive vendore nëpër bankat e Kosovës do ta nxisë zhvillimin duke i zgjeruar kapacitetet e kredihënies në sektor dhe shumat e disponueshme për kredimarrësit vendorë për financim të projekteve në shkallë të gjerë dhe afatgjatë. Kjo do të arrihet duke mundësuar konkurrencë të drejtë mes bankave për rolet udhëheqëse, duke e shmangur përqendrimin e tregut dhe duke i nxitur investimet me pjesëmarrjen më të gjerë, njëkohësisht duke e zvogëluar kohën dhe shpenzimet e ekzekutimit të marrëveshjes.

Me qëllim të lehtësimit të këtyre modifikimeve dhe krijimit të një tregu të rregullt, konkurrues dhe efikas, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) e ka përgatitur këtë Letër Këshilluese, e cila i reflekton pritshmëritë e mbikëqyrjes. Me zhvillimin e tregut, bankat pritet të zhvillojnë udhëzime dhe procedura të brendshme të përshtatshme me rolin e tyre.

Udhëzuesi do të shqyrtohet dhe rishikohet rregullisht për t'i reflektuar çështjet që dalin nga zbatimet në fazën e hershme dhe më tej.

INFORMATA RRETH NATYRËS LIGJORE TË DOKUMENTIT

Kjo Letër Këshilluese është dokument jodetyrues, pasi që nuk është instrument rregullativ i BQK-së sipas ligjit për BQK-në.

Megjithatë, bankat duhet të sigurojnë pajtueshmëri me ligjet gjatë zbatimit të praktikave të kredive të sindikuara në këtë udhëzues, në veçanti, pajtueshmëria me Ligjin për Konkurrencën, për të siguruar konkurrencë të drejtë dhe për t'i shmangur praktikat kundër konkurrencës në treg.

UDHËZUES PËR KREDITË E SINDIKUARA

Letër këshilluese për bankat në Republikën e Kosovës

Përmbajtja

Fjalorthi i termave dhe shkurtesave	6
1. Hyrje	9
1.1. Kreditë e sindikuara	9
1.2. Kolaterali i kombinuar	9
1.3. Dokumentacioni.....	9
1.4. Kujdesi i përbashkët.....	9
1.5. Reciprociteti	9
1.6. Sistemi për menaxhimin e marrëveshjeve	10
2. Qëllimi / Llojet e kredisë	10
2.1. Qëllimet e kredisë	10
2.2. Llojet e kredisë.....	10
3. Palët në marrëveshjen e kredisë së sindikuar	10
3.1. Kredimarrësi / Garantuesi	10
3.2. Aranzhuesi(t) Kryesor të Mandatuar.....	11
3.3. Kredihënësit	11
3.4. Agjenti i kredisë	11
3.5. Agjenti i Sigurisë.....	11
4. Procesi i kredive të sindikuara	12
4.1. Fillimi.....	12
4.2. Kërkesa për propozime	12
4.3. Dorëzimi i propozimeve	12
4.4. Nivelet e miratuara të pjesëmarrjes.....	12
4.5. Nënshkrimi.....	12
4.6. Vlerësimi i propozimeve.....	13
4.7. Dhënia e mandatit	13
4.8. Tregu i pastër.....	13
4.9. Ndarja e roleve.....	13
4.10. Përgatitja e paketës informuese.....	13
4.11. Ftesat për pjesëmarrësit e ardhshëm – Sindikimi i përgjithshëm	14
4.11.1. Përgatitja e ftesës.....	14
4.11.2. Lista e të ftuarve.....	14
4.11.3. Nivelet/Tarifat e pjesëmarrjes	14
4.11.4. Dërgimi i ftesave	14
4.11.5. Prezantimi i kredimarrësit	15
4.11.6. Pyetjet e të ftuarve.....	15
4.11.7. Raportet përcjellëse/të statusit.....	15
4.11.8. Përgjigjet	15
4.12. Përgatitja e dokumentacionit të kredisë	15
4.12.1. Emërimi i këshilltarit ligjor.....	15
4.12.2. Draft dokumentacioni fillestar	15
4.12.3. Shqyrtimi nga AKM-të / Negociatat me kredimarrësin	16
4.12.4. Shqyrtimi nga pjesëmarrësit.....	16
4.13. Hollësitë administrative	16
4.14. Ndarja e niveleve të pjesëmarrjes	16
4.15. Nënshkrimi i dokumentit	16
4.16. Proceset paralele	18
4.17. Korniza kohore.....	19
4.18. Agjencia e kredisë	19
4.19. Tregu dytësor	19
5. Dokumentacioni	19
5.1. Marrëveshja e kredisë	19
5.1.1. Përkufizimet.....	19

5.1.2. Përshkrimi dhe qëllimi.....	20
5.1.3 Kushtet e shfrytëzimit.....	20
5.1.4 Shfrytëzimi.....	20
5.1.5. Pagesa e kredisë.....	20
5.1.6. Parapagesa / Anulimi.....	20
5.1.7. Interesi.....	20
5.1.8. Tarifat.....	20
5.1.9. Kostot shtesë.....	20
5.1.10. Garantimi.....	21
5.1.11. Deklaratat.....	21
5.1.12. Informatat financiare.....	21
5.1.12. Kontratat financiare.....	21
5.1.14. Zotimet.....	21
5.1.15. Ngjarjet e dështimit.....	22
5.1.16. Shitja e pjesëmarrjeve.....	22
5.1.16. Agjenti i Kredisë.....	22
5.1.17. Ligji qeverisës / Juridiksioni.....	22
5.2. Letra e tarifës së menaxhimit.....	22
5.3. Letra e tarifës për agjentin e kredisë.....	22
5.4. Letra e tarifës për agjencinë e sigurisë.....	22
Shtojca A: Kolaterali i përbashkët.....	23
Shtojca B: Roli i agjentit të kredisë.....	24
1. Përmbledhje.....	24
2. Tarifat e agjencisë së kredisë/sigurisë.....	24
3. Detyrat kryesore të Agjentit të Kredisë.....	24

Fjalorthi i termave dhe shkurtesave

Këta terma përdoren në këtë letër dhe në tregun e gjerë të sindikimit:

Avancë	Shuma e një tërheqjeje të vetme në kuadër të kredisë.
Kostot e përgjithshme	Pesë kostot kryesore të kredimarrësit të një kredie të sindikuar: margjina, tarifa administrative, tarifa e zotimit, tarifat e agjencisë dhe shpenzimet e vogla.
Amortizimi	Zvogëlimi gradual i borxhit me kalimin e kohës në një varg këstesh.
Periudha e disponueshmërisë	Periudha kohore mes nënshkrimit të marrëveshjes së kredisë dhe skadimit të zotimit të huadhënësit për t'i avancuar mjetet.
Jetëgjatësia mesatare	Periudha mesatare e vlerësuar e detyrimeve, duke marrë parasysh dispozitat e tërheqjes dhe amortizimit.
Pagesë e grumbulluar	Kësti i fundit i një kredie që është duke u amortizuar, që është shumë më i madh se këstet e mëhershme, për shembull katër këste prej 15% pasuar nga një këst përfundimtar prej 60%.
Pika bazë	Një e qindta e një për qindëshit (0.01%).
Përpjekjet më të mëdha	Kur nuk është nënshkruar një kredi, AKM(-të) do të bëjnë përpjekjet më të mëdha për të tërhequr kredidhënës të mjaftueshëm për ta përfunduar transaksionin në mënyrën që kërkohet nga kredimarrësi.
Dispozitat e zakonshme	Klauzolat në dokumentacion që janë standarde dhe dallojnë shumë pak mes marrëveshjeve.
Udhëheqësi	MLA përgjegjës për udhëheqjen e procesit të sindikimit.
Pagesë e plotë	Ripagimi i një marrëveshjeje me një këst të vetëm në maturitetin final.
Ditë pune	Dita në të cilën bankat rihapen për punë në qendrat përkatëse financiare.
Treg i pastër	Zotimi i kredimarrësit për të mos u përfshirë në financime të tjera që mund t'i bëjnë konkurrencë procesit të sindikimit.
Kredi në grup	Kredi e dhënë nga një grup bankash që pajtohen ta marrin dhe ta mbajnë një kredi nga nënshkrimi, duke e shmangur nevojën për sindikim të përgjithshëm.
Tarifa e zotimit	Tarifë vjetore që i paguhet kredidhënësit për zotimin e pa tërhequr, zakonisht paguhet çdo tre muaj në vonesa.
Kushtet ekzistuese	Çështjet që duhet të adresohen para se kredimarrësi të mund të bëjë tërheqje në kuadër të marrëveshjes së kredisë.

Marrëveshja e konfidencialitetit	Marrëveshje që nënshkruhet nga një pjesëmarrës i ardhshëm që zotohet ta ruajë konfidencialitetin e informacionit të dhënë në të.
Kontratë	Zotim nga kredimarrësi për t'i kryer disa veprime të caktuara, si dorëzimi i pasqyrave financiare.
Vonesë e dyfishtë	Ndodhi e vonesës e nxitur nga një ndodhi e vonesës në kuadër të një financimi tjetër.
€STR	Norma afatshkurtër në euro për depozitat e pasiguruara, e përdorur shpesh si normë referimi për kreditë në euro.
Ndodhi e vonesës	Një prej një varg ngjarjesh, që u jep të drejtën kredidhënësve për ta anuluar marrëveshjen dhe për t'i deklaruar të gjitha shumat që duhet të paguhet menjëherë.
Limiti i shpenzimeve	Marrëveshje nga AKM(-të) për t'i kufizuar shpenzimet e aranzhimit të një marrëveshjeje të sindikuar që kredimarrësi do të jetë i obliguar ta paguajë.
Agjent i kredisë	Shih Kapitullin 3.4 / Shtojca B.
Shuma e fundit	Shuma e pjesëmarrjes që i ndahet një kredidhënësi. Nëse kredia është rritur, kjo mund të jetë më pak se sa ka ofruar një bankë për të marrë.
Grejs periudha	Periudha mes nënshkrimit të kredisë dhe këstit të parë të pagesës.
ShTK	Shoqata e Tregut të Kredive.
Bankat shumicë	Një grup bankash brenda një sindikate zotimet e të cilave zakonisht shkojnë përtej 50% ose 66⅔%, me kapacitetin për ta detyruar sindikatën në tërësi për t'i lajmëruar ndodhitë e vonesave dhe për t'u pajtuar për disa lëshime dhe ndryshime.
Tarifa e menaxhimit	Tarifa e pagueshme si përqindje e shumës kryesore që do t'i paguhet AKM(-të) pas nënshkrimit.
Mandati	Autoriteti për ta rritur kredinë në emër të kredimarrësit.
Aranzhuuesi(t) kryesor(ë) i (të) mandatuar	Një apo më shumë banka të mandatuara nga kredimarrësi për ta aranzhuar një kredi të sindikuar.
Margjina	Norma e interesit mbi normën përkatëse bazë që e kërkon kredidhënësi.
Maturiteti	Data në të cilën skadon një kredi dhe duhet të paguhet plotësisht.
Peng negativ	Kontratë përmes të cilës kredimarrësit dhe garantuesit zotohen të mos lejojnë krijimin apo ekzistimin e borxhit të siguar, përveç me kushtet e vendosura me kredidhënësit.

Rritje e paplanifikuar	Rritja e një shume përtej kufirit të marrëveshjes, shih Kapitullin 4.14.
Tarifa e pjesëmarrjes	Tarifë që duhet të paguhet në shumën e fundit të çdo kredidhënësi.
Precipium	Pjesa e tarifës së menaxhimit që e mban AKM(të) prej Tarifës së Menaxhimit për punën e tyre në aranzhimin e kredisë.
Përfaqësimet & Garancitë	Një varg deklaratash ligjore me të cilat rregullohet dokumentacioni i kredisë ¹ dhe/ose faktike që i bën kredimarrësi, në bazë të të cilave bankat pajtohen të marrin pjesë në kredi.
Kredi fleksibile	Kredi që ia lejon kredimarrësit të bëjë tërheqjen dhe të paguajë sipas deskrecionit të tij.
Zbritje	Reduktimi i një zotimi fillestar përmes sindikimit.
Shtrirje	Një fjalë tjetër për “margjinën”.
Kredi me afat të caktuar	Kredi me periudhë të caktuar të tërheqjes dhe afat të pagesës (krahaso me kredi të kthyeshme).
Listë e kushteve	Dokument që përcakton termat dhe kushtet kryesore të një transaksioni mes kredimarrësit dhe AKM(ve).
Vërtetimi i transferim	Vërtetim që lëshohet në kuadër të marrëveshjes për kredinë e sindikuar që ia lejon kredidhënësit t’ia transferojë krejt kredinë apo një pjesë të saj një pale tjetër.

1. Hyrje

1.1. Kreditë e sindikuara

Kreditë e sindikuara iu mundësojnë kredidhënësve t'i japin shuma të mëdha një kredimarrësi të vetëm, ku shumat e përfshira e tejkalojnë apetitin apo burimet kredituese të një kredidhënësi të vetëm. Në mungesë të tregut të kredive të sindikuara, kur nevojat e një kredimarrësi e tejkalojnë kapacitetin e një kredidhënësi të vetëm, bankat i kanë zgjeruar kreditë individuale direkte, secila sipas kushteve të tyre, duke përdorur dokumentacionin e tyre dhe duke marrë asete të ndryshme si kolateral. Sindikimi i obligon bankat që të japin kredi së bashku me të njëjtin dokumentacion, me kushte dhe kolateral të përbashkët.

Me qëllim që të zvogëlohen kostot e transaksioneve dhe koha e përpunimit, sindikimi kërkon që të bëhen disa ndryshime në praktikën e kredidhënies direkte.

1.2. Kolaterali i kombinuar

Kredidhënia e sindikuar kërkon ndryshim në modelin e kredidhënies së drejtpërdrejt ku çdo kredidhënës merr siguri mbi një aset të caktuar si kolateral. Një alternativë tjetër është që të grupohen asetet dhe siguria që e mban agjenti i sigurisë në emër të të gjithë kreditorëve të siguruar. Për këtë është dhënë një shpjegim dhe diskutim në Shtojcën A.

1.3. Dokumentacioni

Bankat inkurajohen t'i përdorin shabllonet e Shoqatës së Tregut të Kredive (ShTK) për dokumentacionin, që përfshin të gjitha fazat e ciklit të transaksionit nga listat e kushteve deri tek marrëveshja e kredisë. Këto shabllone duhet të rishikohen dhe nëse është e nevojshme, të përshtaten për t'iu përmbajtur ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë. Disponueshmëria dhe përdorimi i shablloneve të ShTK-së rregullohet me termat dhe kushtet e AKM-së.

1.4. Kujdesi i përbashkët

Siç përshkruhet në Kapitullin 4.2.2., bankat që ftohen në sindikatë ("të ftuarit") mbështeten në një paketë informuese të përgatitur nga Aranzhuesi(t) kryesor(ë) i (të) mandatuar (AKM-të) në emër të kredimarrësit (shih Kapitullin 4.10). Ato nuk ushtrojnë kujdes të pavarur përtej analizës së paketës, e cila duhet të jetë faktike dhe objektive, pa përfundime apo rekomandime, që iu lejon pjesëmarrësve t'i marrin vetë vendimet e tyre.

1.5. Reciprociteti

Në mënyrë që kredimarrja e sindikuar t'i rrisë në maksimum kapacitetet e tregut të bankave për kredimarrësit individual, bankat duhet të jenë të përgatitura për ta shqyrtuar mbështetjen e kredive të aranzhuara nga institucionet me të cilat zakonisht janë në konkurrencë. Këtë e bëjnë duke pritur që, në rastet e ardhshme kur ato veprojnë si aranzhuese, bankat e tjera do ta shqyrtojnë të njëjtën gjë. Ky proces, që njihet si reciprocitet është joformal dhe nuk paraqet kërkesë që banka ta vlerësojë një kredi individuale përveç se në përputhje me procedurat dhe standardet e saj për kredi.

Për një treg të suksesshëm të sindikatës nevojitet ekuilibër mes konkurrencës dhe bashkëpunimit, ashtu që bankat duhet të konkurrojnë pa bashkëpunim të fshehtë për mandate, por i mbështesin transaksionet e njëra-tjetrës në sindikatë.

1.6. Sistemi për menaxhimin e marrëveshjeve

Sistemet elektronike (Intralinks, Debt Domain) janë të disponueshme për ta automatizuar menaxhimin e marrëveshjeve. Këto përdoren për t'i mirëmbajtur bazat e të dhënave të investitorëve, për të dërguar ftesa dhe paketa informuese, për ta shpërndarë dokumentacionin dhe për ta menaxhuar procesin e mbylljes. Këto sisteme janë të zhvilluara mirë dhe efektive, por nevojiten shpenzime të konsiderueshme sa i përket kostos, instalimit dhe trajnimit. Me një numër të kufizuar investitorësh dhe transaksionesh, bankat mund të zgjedhin ta shtyjnë këtë investim derisa të krijohet tregu.

2. Qëllimi / Llojet e kredisë

2.1. Qëllimet e kredisë

Qëllimi i kredisë së sindikuar është t'i financojë projektet në shkallë të gjerë dhe afatgjata, duke përfshirë, përveç tjerash, investimet në energji të pastër dhe investime të tjera intenzive kapitale..

2.2. Llojet e kredisë

Marrëveshjet e kredisë së sindikuar janë zakonisht kredi me afat të caktuar. Ato mund ta përfshijnë një apo më shumë garantues.

Në kuadër të marrëveshjes së kredisë me afat të caktuar, kredidhënësit zotohen t'ia huazojnë kredimarrësit një shumë të caktuar të parave për një periudhë të caktuar kohore ("me afat të caktuar").

Zakonisht, kredimarrësi e ka një periudhë të shkurtër pas ekzekutimit të marrëveshjes së kredisë ("periudha e disponueshmërisë"), për t'i tërhequr kreditë deri në një limit maksimal të kredisë. Kredimarrësi zakonisht do t'i paguajë tarifat e zotimit në lidhje me shumat e zotuaratë pa tërhequra gjatë periudhës së disponueshmërisë. Interesi i kredive të sindikuara zakonisht mbledhet me një normë variabile (e jo me normë fikse, që gjendet më shpesh në tregun e bondeve). Kjo normë e ndryshueshme e interesit ricaktohet në mënyrë periodike, ku periudhat që përdoren më së shpeshti janë një, tre dhe gjashtë muaj.

Kredia mund të paguhet me këste (në të cilin rast, kredia zakonisht përshkruhet si "kredi amortizuese") apo përmes një pagese në fund të kredisë (në të cilin rast kredia zakonisht përshkruhet si kredi me terma të pagesës së plotë). Parapagimi i kredisë lejohet, zakonisht pa ndëshkime. Shumat që paguhen (ose parapaguhen) nuk mund të tërhiqen përsëri.

3. Palët në marrëveshjen e kredisë së sindikuar

3.1. Kredimarrësi / Garantuesi

Procesi i sindikimit iniciohet nga kredimarrësi, obligimet e të cilit mund të garantohen nga një garantues. Kredimarrësi dhe garantuesi mund të jenë sovran (çfarëdo entiteti për borxhet e të cilit është përgjegjës Shteti), ndërmarrjet publike, sektori privat apo mjetet që kanë qëllim të veçantë, për shembull, për projektet publiko-private të infrastrukturës.

3.2. Aranzhuesi(t) Kryesor të Mandatuar

Kredimarrësi e emëron një apo më shumë banka duke iu dhënë mandat² për të vepruar si Aranzhues(it) kryesor(ë) të mandatuar (AKM) për marrëveshjen.

3.3. Kredidhënësit

AKM(-të), së bashku me bankat që i bashkohen kredisë si kredidhënës në sindikatë (“pjesëmarrësit”), zotohen ta japin shumën totale të kredisë në shumat e përcaktuara në marrëveshjen e kredisë. Bankat nuk janë përgjegjëse për detyrimet e financimit të njëra-tjetrës në kuadër të marrëveshjes së kredisë.

3.4. Agjenti i kredisë

Për ta lehtësuar procesin e administrimit të kredisë në baza ditore, AKM-të (në konsultim me kredimarrësin) do ta emërojnë një bankë nga sindikata për të vepruar si Agjent i Kredisë. Agjenti i Kredisë vepron si agjent i kredidhënësve, jo i kredimarrësit dhe ka një numër funksionesh të rëndësishme:

- *Person Kontaktues*: mban kontakt me kredimarrësin dhe i përfaqëson pikëpamjet e sindikatës;
- *Monitorues*: monitoron pajtueshmërinë e kredimarrësit me termat e caktuar të identifikuar të marrëveshjes së kredisë;
- *Postier dhe evidentues*: pranon të gjitha njoftimet, vërtetimet e pajtueshmërisë, pasqyrat financiare dhe informatat e tjera të nevojshme nga kredimarrësi dhe ua shpërndan ato kredidhënësve; dhe
- *Agjent i pagesave*: kredimarrësi i bën të gjitha pagesat e interesit dhe pagesat e principalit dhe çdo pagesë tjetër të paraparë me marrëveshjen e kredisë tek Agjenti i Kredisë. Pastaj Agjenti i Kredisë ua kalon këto para bankave të cilave iu takojnë. Ngjashëm, kredidhënësit i japin mjete kredimarrësit përmes Agjentit të Kredisë, që është i përgjegjshëm për organizimin e “shfrytëzimit” apo “tërheqjes” së kredisë.

Agjenti i Kredisë e merr një tarifë nga kredimarrësi, që zakonisht paguhet në baza vjetore.

Diskutimi i mëtejshëm për rolin e Agjentit të Kredisë është bashkangjitur si Shtojca B.

3.5. Agjenti i Sigurisë

Nëse kredia do të kolateralizohet, emërohet një kredidhënës nga sindikata për të vepruar si Agjent i Sigurisë për ta mbajtur kolateralin në trust për të mirën e të gjithë kredidhënësve. Kjo siguron që: (1) një subjekt i vetëm është përgjegjës për aspektet administrative të sigurisë (siç është mbajtja e dokumenteve të pronësisë dhe dokumenteve të tjera lidhur me pronësinë e vendosur si kolateral) dhe për të bërë shpërndarje tek kredidhënësit e siguruar lidhur me zbatimin; dhe (2) kur një kredidhënës ia cakton ose ia bart interesin e vet një subjekti tjetër, kredidhënësi i ri do të përfitojë nga paketa ekzistuese e sigurisë pa nevojën për ta regjistruar përsëri sigurimin apo për të marrë sigurim të ri. Detyrat e Agjentit të Sigurisë do të përcaktohen qoftë në një marrëveshje të veçantë për trustin e sigurisë apo në marrëveshjen e kredisë. Agjenti i Sigurisë e merr një tarifë nga kredimarrësi, që zakonisht paguhet në baza vjetore.

² Shih Kapitullin 4.1

4. Procesi i kredive të sindikuara

4.1. Fillimi

Pasi t'i identifikojë kërkesat e tij, kredimarrësi do të kërkojë propozime për një kredi të sindikuar. Shuma maksimale e kredisë së sindikuar do t'i reflektojë limitet e kredidhënies së bankave. Megjithatë, bankat mund të kenë kredi ekzistuese apo dëshirojnë ta ruajnë hapësirën e mundshme brenda limiteve për një kredimarrës (brenda të cilave duhet të përfshihen pjesëmarrjet në kredi të sindikuara) për biznes në të ardhmen, prandaj për kreditë që e tejkalojnë kapacitetin e bankave vendore mund të nevojiten kredidhënës shtesë.

4.2. Kërkesa për propozime

Kredidhënësi mund të zgjedhë:

- Ta negociojë mandatin drejtpërdrejt me një apo më shumë banka me të cilat bashkëpunon; apo
- Të kërkojë oferta konkurruese, që mund të ofrohen qoftë nga bankat individuale që veprojnë vetëm, apo nga grupe bankash që veprojnë së bashku. Ofertimi krijon kushte më të mira por rrezikon largimin e ofertuesve që nuk shpallen fitues.

4.3. Dorëzimi i propozimeve

Propozimet duhet të dorëzohen te kredimarrësi. Kjo e bën më të lehtë për kredimarrësin që t'i krahasojë propozimet konkurruese dhe krijon bazën e ofertës për pjesëmarrësit në sindikatë.

Gjatë vlerësimit të propozimeve, kredimarrësi zakonisht merr parasysh përbërësit e përcaktimit të çmimit të principalit:

- Normën e interesit, e shprehur si margjinë mbi €STR apo standarde të tjera që përdoren në tregun vendor.
- Tarifën e menaxhimit, që paguhet në fillim në shumën e principalit të kredisë. Një pjesë e kësaj do t'iu paguhet pjesëmarrësve që i bashkohen kredisë në sindikatën e përgjithshme (shih Kapitullin 4.11.3).
- Tarifën e zotimit, që paguhet nga nënshkrimi i shumës së pa tërhequr të kredisë për ta reflektuar koston oportune të kapitalit të shoqëruar të riskut.
- Tarifat vjetore që paguhet për Agjentin e Kredisë/Sigurisë.
- Shpenzimet tjera administrative, si tarifat ligjore (që mund ta kenë një limit të shpenzimeve).

4.4. Nivelet e miratuara të pjesëmarrjes

Si pjesë e propozimit të tyre, AKM-të e ardhshme duhet ta tregojnë nivelin maksimal në të cilin e kanë miratimin për të marrë pjesë në kredi. Çdo AKM brenda një grupi ofertues në përgjithësi kërkon miratim për pjesëmarrjen e njëjtë përfundimtare, edhe pse mes vete mund të pajtohen për përjashtime ndaj kësaj.

4.5. Nënshkrimi

Propozimet për kredimarrësit mund të nënshkruhen, që do të thotë se AKM-të zotohen ta japin shumën e plotë të kredisë edhe nëse shumën e ngritur nga pjesëmarrësit në sindikatë të përgjithshme është më pak se që kanë shpresuar. Nëse propozimi duhet të nënshkruhet, çdo

nënshkrues duhet ta ketë kapacitetin dhe miratimin për ta financuar tërë shumën e nënshkruar deri në maturitet.

4.6. Vlerësimi i propozimeve

Gjatë vlerësimit të propozimeve të financimit alternativ, kredimarrësit zakonisht i amortizojnë shpenzimet administrative (tarifat e menaxhimit plus shpenzimet ligjore dhe të tjera) mbi jetëgjatësinë mesatare të kredisë³. Sa më e vogël të jetë kredia dhe jetëgjatësia e kredisë, aq më të mëdha janë kostot administrative në vit ekuivalente si përqindje e shumës së principalit.⁴

4.7. Dhënia e mandatit

Pasi t'i ketë negociuar termit e kënaqshëm apo pasi ta ketë zgjedhur ofertën më të mirë konkurruese, kredimarrësi e jep mandatin për ta aranzhuar financimin AKM-ve (shih shabllonin për AKM). Nëse AKM-të janë të përgatitura për ta dhënë vetë shumën e plotë të kredisë (zakonisht referohen si kredi “e kombinuar”), nuk nevojitet sindikim tjetër.

4.8. Tregu i pastër

Nëse nevojitet sindikim i mëtejshëm, kredimarrësi duhet të zotohet që nuk do të përpiqet të marrë kredi të tjera, të sindikuara apo bilaterale, që mund të konkurrojnë me sindikimin (“tregu i pastër”) derisa të përfundojë procesi.

4.9. Ndarja e roleve

Brenda procesit të sindikimit ekzistojnë disa role. Kur mandati i jepet më shumë se një AKM-je, këto role në përgjithësi ndahen mes tyre, zakonisht me marrëveshje reciproke por nganjëherë sipas zgjedhjes së kredimarrësit.

Rolet janë:

- **Udhëheqësi** iu dërgon ftesa pjesëmarrësve të ardhshëm, trajton pyetjet dhe mbledh përgjigje (shih Kapitullin 4.11)
- **Banka e informatave** përgatit paketën informuese të cilën pjesëmarrësit e ardhshëm e përdorin për analizat e kredisë (shih Kapitullin 4.10). Nëse kjo përfshin më shumë se informatat që janë publike, marrësve mund t’iu kërkohet të nënshkruajnë marrëveshje të konfidencialitetit (MK).
- **Banka e dokumentacionit** negocion dokumentacionin e kredisë me kredimarrësin dhe kredidhënësit (Shih Kapitullin 4.12).
- **Agjenti i Kredisë** (shih Kapitullin 3.4 / Shtojca B) është përgjegjës për administrimin e kredisë nga nënshkrimi.
- **Agjenti i Sigurisë** e mban kolateralin për kredinë në emër të kredidhënësve (shih Kapitullin 3.5).

4.10. Përgatitja e paketës informuese

³ Zakonisht llogaritet si mesatarja e grejs periudhës dhe afatit, pra një kredi pesë vjeçare që paguhet në këste duke filluar pas dy vitesh e ka jetëgjatësinë mesatare prej $(5+2)/2 = 3.5$ vite.

⁴ €100k shpenzime administrative, p.sh. €75k të tarifës së aranzhimit dhe €25k të shpenzimeve ligjore, në një kredi prej €50m është përafërsisht e barabartë (duke i injoruar kostot e zbritjes në rast të normës së ulët të interesit) me $2.00\%/3.5 = 0.57\%$ në vit.

Pas dhënies së mandatit, Banka e Informatave do të punojë me kredimarrësin për ta përgatitur një paketë informuese (Paketa Informuese) të cilën pjesëmarrësit e ardhshëm do ta përdorin për t'i bërë analizat e kredisë. Këtu duhet të përfshihet gjithçka që ka qenë e disponueshme për AKM(-të) gjatë vlerësimit të tyre, duke përfshirë, nëse i kanë, pasqyrat financiare, projektimet, modelet financiare, studimet e fizibilitetit, etj.

Ndërkohë që paketa informuese mund të formatohet për ta lehtësuar përgatitjen e aplikimit të një marrësi për kredi, duhet të jetë faktike dhe objektive, pa përfundime apo rekomandime. Marrësit duhet t'i kryejnë vetë analizat e tyre për ta marrë vendimin nëse do të marrin pjesë apo jo.

Kredimarrësi ua konfirmon me shkrim AKM(-ve) që Paketa Informuese nuk përmban asnjë deklaratë të gabuar të fakteve kryesore, as nuk është lënë jashtë ndonjë fakt që është i rëndësishëm për tu shpalosur para kredidhënësit të mundshëm; po ashtu e autorizon AKM(-të) për të nxjerrë Paketa Informuese për kredidhënësit e mundshëm.

4.11. Ftesat për pjesëmarrësit e ardhshëm – Sindikimi i përgjithshëm

4.11.1. Përgatitja e ftesës

Udhëheqësi e përgatit ftesën për bankat. Lista e kushteve duhet të jetë ajo që është vendosur me kredimarrësin, përveç nivelit të tarifave të menaxhimit dhe agjencisë që nuk shpalosen. Qëllimi i ftesës është të nxitet marrësi të lidhë marrëdhënie kredidhënieje me kredimarrësin, prandaj duhet të miratohet nga kredimarrësi.

4.11.2. Lista e të ftuarve

Udhëheqësi e përgatit listën e të ftuarve në sindikim. Përveç nëse dihet se një bankë e caktuar nuk dëshiron apo nuk mund të marrë pjesë në kredi, ftesat në përgjithësi mund t'iu dërgohen të gjitha bankave (përveç AKM(-ve)) aktive në tregun kosovar.

4.11.3. Nivelet/Tarifat e pjesëmarrjes

Gjatë përgatitjes së ftesës, Udhëheqësi, në konsultim me AKM-të tjerë, nëse ka, vendos për shumën të cilën të ftuarit do të ftohen ta zotojnë dhe pjesën e tarifës së menaxhimit që do t'iu paguhet pjesëmarrësve si tarifë e pjesëmarrjes. Pjesa që mbahet nga AKM(-të) nganjëherë quhet precipium. Të ftuarve mund t'iu ofrohet më shumë se një nivel i zotimit, në të cilin rast niveli më i lartë tërheq një tarifë më të madhe⁵. Në rastet kur është e praktikueshme, AKM(-të) duhet ta ofrojnë një nivel të pjesëmarrjes për t'i akomoduar limitet e kredidhënies të bankave të vogla.

4.11.4. Dërgimi i ftesave

Ftesa mund t'i adresohet individit përgjegjës për sindikim (nëse ka) në bankën e ftuar. Nëse udhëheqësi e njeh identitetin e individit i cili me gjasë do ta përpunojë ftesën, mund t'iu dërgohet atij/asaj. Udhëheqësi duhet ta telefonojë marrësin brenda 48 orësh pas dërgimit të ftesës për të

⁵ Për shembull, nëse tarifa e menaxhimit që i paguhet kredimarrësit është 1.00%, AKM-të mund të vendosin t'i mbajnë 0.40% dhe t'iu ofrojnë pjesëmarrësve tarifë të pjesëmarrjes prej 0.60% për zotimin prej €7.5 milionë, ose 0.45% për zotimin prej €5 milionë apo 0.30% për zotimin prej €2.5 milionë.

vërtetuar që e ka marrë dhe për të pyetur për shprehjen fillestare të interesimit – nëse marrësi ka gjasa ta shpije përpara kredinë për miratim.

Me numrin e kufizuar të të ftuarve, Udhëheqësi mund të zgjedhë të bëjë një komunikim të parë përmes telefonit për ta kuptuar shkallën fillestare të interesimit, duke e dërguar ftesën vetëm nëse banka synon ta shpije tutje. Nëse marrësi shpreh interesim, Udhëheqësi do ta përcjellë Paketën Informuese të përgatitur nga Banka e Informatave. Nëse kërkon kredimarrësi, Udhëheqësi mund t'i kërkojë të ftuarit të lidhë marrëveshje konfidencialiteti (shablloni i ShTK-së) para se ta dërgojë Paketën Informuese.

4.11.5. Prezantimi i kredimarrësit

Pasi që të ftuarit ta kenë ftesën, listën e kushteve, Paketën Informuese dhe dokumentet tjera, AKM(-të) mund t'i kërkojnë kredimarrësit ta bëjë një prezantim të të ftuarve ose ta organizojë një vizitë te kredimarrësi dhe objektet e tij.

4.11.6. Pyetjet e të ftuarve

Çdo pyetje që mund ta kenë të ftuarit rreth Paketës Informuese duhet t'i adresohet Udhëheqësit, i cili do t'iu përgjigjet atyre që mundet dhe do të marrë përgjigje nga kredidhënësi për të tjerat. Udhëheqësi mund të zgjedhë t'i ndajë të gjitha pyetjet dhe përgjigjet me të gjithë të ftuarit (duke përfshirë ata që nuk kanë bërë pyetje) për të siguruar qasje të barabartë në informacion.

4.11.7. Raportet përcjellëse/të statusit

Udhëheqësi duhet ta thërrasë çdo pjesëmarrës të ardhshëm çdo javë dhe të përgatisë raporte të rregullta rreth progresit të sindikimit, duke përfshirë statusin e çdo të ftuari (e pranuar, duke shqyrtuar, duke përpunuar, e refuzuar) të cilin e ndan me kredimarrësin dhe AKM-të e tjerë.

4.11.8. Përgjigjet

Të ftuarve zakonisht iu jepen rreth katër javë për t'i marrë miratimet (më shumë për transaksione më të ndërlikuara). Kërkesat e arsyeshme për zgjatje të afatit kohor për përgjigje zakonisht duhet të pranohen. Është mirë që bankat të cilat vendosin të mos marrin pjesë ta informojnë Udhëheqësin sa më shpejt. Pranimi për të marrë pjesë përfshin shumën e miratuar dhe përfshin plotësimin e dokumentacionit të kënaqshëm.

4.12. Përgatitja e dokumentacionit të kredisë

4.12.1. Emërimi i këshilltarit ligjor

Praktika standarde në tregjet ndërkombëtare është që dokumentacioni i kredisë së sindikuar gjithmonë përgatitet nga një këshilltar i jashtëm ligjor për ta shmangur përgjegjësinë në rast të gabimit të kredimarrësit. Edhe kredimarrësi mund të zgjedhë ta angazhojë këshilltarin e vet.

4.12.2. Draft dokumentacioni fillestar

Gjatë sindikimit, këshilltari ligjor i kredidhënësit e përgatit draftin e parë të marrëveshjes së kredisë.

4.12.3. Shqyrtimi nga AKM-të / Negociatat me kredimarrësin

Drafti i parë fillimisht dërgohet nga Banka e Dokumentacionit të AKM-të e tjera për komente, të cilin duhet ta kufizojnë me çështjet e rëndësishme, e jo të jetë “listë dëshirash”. Pastaj, ajo i dorëzohet dhe negociohet me kredimarrësin. Banka e Dokumentacionit duhet të përpiqet ta ketë një draft të dakorduar me kredimarrësin deri në mbyllje të sindikimit.

4.12.4. Shqyrtimi nga pjesëmarrësit

Ky draft pastaj iu dërgohet bankave që janë zotuar në sindikim, duke iu nënshtruar dokumentacionit. Praktika e tregut është që ato e konfirmojnë që dokumenti tashmë është negociuar dhe komentojnë vetëm për çështjet që mund ta pengojnë pjesëmarrjen e tyre.

4.13. Hollësitë administrative

Hollësitë administrative, duke përfshirë udhëzimet për pagesa dhe emrat e zyrtarëve përgjegjës për monitorimin e vazhdueshëm të transaksioneve, duhet të merren nga çdo anëtar i sindikatës dhe t’i dërgohet Agjentit të Kredisë.

4.14. Ndarja e niveleve të pjesëmarrjes

Kur pjesëmarrësit ta kenë konfirmuar pranimin e dokumentacionit, Udhëheqësi i ndan nivelet përfundimtare të pjesëmarrjes. Nëse shumat e zotuar në sindikim, së bashku me nivelet e dëshiruara të pjesëmarrjes së AKM-ve, e tejkalojnë shumën e kredisë, AKM(-të) dhe kredimarrësi mund të vendosin:

- i. Ta rrisin shumën e kredisë. Nëse kredimarrësi është korporatë, asnjë rritje nuk duhet të jetë në një shumë të mjaftueshme për të ndikuar ndjeshëm në aftësinë kreditore të kredimarrësit. Në rast të rritjes, tarifa e menaxhimit paguhet sipas përqindjes origjinale të shumës së rritur të principalit; ose
- ii. Nëse ende ka rritje të paplanifikuara, AKM-të do t’i ndajnë nivelet e pjesëmarrjes sipas vendimit të tyre. Nuk është e nevojshme që të gjitha AKM-të të nënshkruajnë për të njëjtën shumë⁶ por pjesëmarrësve në sindikim të përgjithshëm që bëjnë zotime të barabarta do t’iu ndahet shuma e njëjtë përveç nëse të gjitha palët pajtohen ndryshe dhe
- iii. Kur reduktohet zotimi i një pjesëmarrësi, tarifa e pjesëmarrjes duhet të paguhet në shumën e pjesëmarrjes së ndarë të tyre në normën e zbatueshme të zotimit të tyre.⁷

4.15. Nënshkrimi i dokumentit

Banka e Dokumentacionit aranzhon nënshkrimin e dokumentacionit mes kredimarrësit, AKM(-ve), kredidhënësve, Agjentit të Kredisë dhe Agjentit të Sigurisë. Nëse dëshiron kredimarrësi, kjo mund të bëhet në një organizim ku ftohen të gjitha palët, ose nëse është e mundur, dokumentacioni mund të nënshkruhet në distancë.

Marrëveshja e kredisë nuk përfshin shumat e tarifave të menaxhimit dhe të agjencive të kredisë dhe sigurisë që duhet të paguhet nga kredimarrësi. Këto evidentohen në letra (shabllone të


⁶ AKM-të që e kanë një marrëdhënie të gjerë me kredimarrësin mund të zgjedhin ta reduktojnë pjesëmarrjen e tyre për të mbajtur hapësirë në kuadër të limiteve të tyre të përgjithshme të kredisë dhe portfolios për biznese të tjera.

⁷ Në rast të niveleve të zotimit të përdorura në paragrafin 4/11/3 më sipër, pjesëmarrësi që i zoton €7.5m që ulet në €5m do ta merrte një tarifë prej 0.60% x €5m.

ShTK-së) mes kredimarrësit dhe AKM(-ve), Agjentit të Kredisë dhe Agjentit të Sigurisë respektivisht.

4.16. Proceset paralele

Proceset paralele të sindikimit të përgjithshëm mund të përmbliidhen si më poshtë:



4.17. Korniza kohore

Një kornizë tipike kohore për kredinë e drejtpërdrejt të sindikuar mund të jetë si në vijim:

Dita	Sindikimi	Dokumentacioni
1	Kredimarrësi kërkon propozime për një transaksion të sindikuar	
22	Bankat përgjigjen	
29	Dhënia e mandatit	
36		Drafti i parë për AKM-të
43	Lansimi i sindikimit	Komentet e AKM-së
50	Prezantimi i kredimarrësit	Drafti për kredimarrësin
71	Përgjigjet nga të ftuarit	Drafti i dakorduar me kredimarrësin
72		Drafti për pjesëmarrësit
79		Përgjigjet nga pjesëmarrësit
82	Ndarja e pjesëmarrjeve	Dokumentacioni i dakorduar
85	Nënshkrimi	

4.18. Agjencia e kredisë

Pas nënshkrimit të dokumentacionit, administrimi i kredisë kalon tek Agjenti i Kredisë, funksioni dhe detyrat e të cilit janë përshkruar në Kapitullin 3.4 dhe në Shtojcën B.

Dokumenti i Shoqatës së Tregut të Kredive (Praktika e Agjencisë) e përcakton më hollësisht themelimin dhe funksionimin e agjencisë së kredisë. Bankat në Kosovë që janë fialiale e bankave me një funksion të agjencisë diku tjetër mund ta shqyrtojnë mundësinë e përdorimit të atij personeli për ta trajnuar stafin. Ndërkohë që këto departamente janë duke u krijuar, një masë e përkohshme mund të jetë që të kryhen punët e agjencisë së kredisë nga zyrat jashtë vendit.

4.19. Tregu dytësor

Marrëveshjet e kredive duhet të përfshijnë vërtetimet e transfereve për ta krijuar një treg të brendshëm për borxhin e sindikuar. Këto iu mundësojnë bankave t'i tregtojnë pjesëmarrjet me dokumentacion minimal dhe paraqesin ndryshime në marrëveshjen origjinale të kredisë duke i zëvendësuar krejtësisht të drejtat dhe obligimet e shitësit me blerësin.

Tregu likuid për borxhet iu mundëson bankave t'i lirojnë limitet për biznese të reja dhe t'i menaxhojnë portfoliot e tyre për ta shmangur sektorin apo koncentrimet e tjera.

5. Dokumentacioni

5.1. Marrëveshja e kredisë

Klauzolat kryesore në marrëveshjen e kredisë (shih shabllonin e ShTK-së) përfshijnë:

5.1.1. Përkufizimet

Këtu përkufizohen termat e përdorur në marrëveshje që janë të rëndësishme për funksionin e saj. Në përgjithësi, shkruhen me shkronjë të madhe.

5.1.2. Përshkrimi dhe qëllimi

Përfshin përshkrimin se a është kredi me afat të caktuar apo kredi fleksibile dhe qëllimin për të cilin do të përdoren mjetet nga kredimarrësi.

5.1.3 Kushtet e shfrytëzimit

Obligimet e kredidhënësve varen prej përmbushjes së kushteve (“precedenti i kushteve”) duke përfshirë dërgimin e dokumenteve që dëshmojnë ekzistimin dhe kompetencat e kredimarrësit/garantuesit dhe veprimet korporative që i kanë ndërmarrë për ta autorizuar ekzekutimin e marrëveshjes së kredisë. Në marrëveshjen e kredisë përcaktohet një listë e dokumenteve të nevojshme.

5.1.4 Shfrytëzimi

Këtu përshkruhet procesi përmes të cilit kredimarrësi e dorëzon kërkesën tek Agjenti i Kredisë për ta tërhequr kredinë.

5.1.5. Pagesa e kredisë

Kjo e përcakton bazën në të cilën do të paguhet kredia nga kredimarrësi.

5.1.6. Parapagesa / Anulimi

Këtu përcaktohen kushtet se si mund të paguhet kredia para datës së planifikuar dhe të anulohen zotimet e pa tërhequra. Parapagimi zakonisht lejohet tërësisht ose pjesërisht pa ndëshkim në ndonjë datë të pagesës së interesit me kusht që kredimarrësi ta ketë njoftuar Agjentin e Kredisë së paku 30 ditë më herët.

5.1.7. Interesi

Këtu përfshihet:

- Llogaritja e normës së interesit (kosto e mjeteve plus margjina)
- Periudhat e interesit (kredimarrësi zakonisht e ka mundësinë e zgjedhjes mes 1, 3 ose 6 muaj)
- Interesi për shumat e papaguara

5.1.8. Tarifat

Duke përfshirë:

- Tarifën e zotimit që paguhet për pjesën e pa tërhequr të kredisë
- Tarifat e menaxhimit (i referohen letrës së bashkëpunimit ku përcaktohet shumata)
- Tarifat e Agjencisë së Kredisë dhe Sigurisë (po ashtu në letrën e bashkëpunimit)

5.1.9. Kostot shtesë

Këtu përcaktohen rrethanat kur mund të jetë e nevojshme të mbulohen kostot shtesë të shkaktuara nga kredidhënësit në avancimin e kredisë.

5.1.10. Garantimi

Nëse kredia garantohet nga një garantues, zakonisht përfshihet në marrëveshjen e kredisë.

5.1.11. Deklaratat

Kredimarrësi dhe garantuesi deklarojnë që:

- Janë të përfaqësuar zyrtarisht dhe ekzistojnë me dëshmi
- Obligimet e tyre në marrëveshjen e kredisë janë të vlefshme dhe detyruese
- Marrëveshja nuk është në kundërshtim me asnjë obligim tjetër detyrues
- Janë ndërmarrë të gjithë hapat e brendshëm për ta autorizuar kredimarrjen dhe ekzekutimin e marrëveshjes së kredisë
- Nuk janë në dështim në pagesa në ndonjë marrëveshje tjetër kreditore
- Informacioni i dhënë në pasqyrat e tyre financiare dhe i paraqitur tek kredidhënësit është i saktë dhe materialisht i plotë
- Asnjë kredidhënës tjetër nuk ka renditje më të lartë të pa shpalosur sa i përket pagesës
- Nuk e kanë shkelur asnjë pjesë tjetër të legjislacionit duke përfshirë atë mjedisor, social, kundër terrorizmit apo pastrimit të parave.

Këto deklarata konsiderohen të përsëritura gjatë tërë kohëzgjatjes së kredisë.

5.1.12. Informatat financiare

Kredimarrësi dhe garantuesi zotohen të paraqesin kopje të pasqyrave të tyre financiare dhe informatat e tjera financiare që i kërkojnë kredidhënësit me arsye. Po ashtu zotohen t'i njoftojnë kredidhënësit nëse janë në dështim në pagesa për ndonjë kredi tjetër.

5.1.12. Kontratat financiare

Këtu mund të përfshihen:

- Vlera minimale e prekshme neto
- Raporti maksimal i borxhit total me vlerën e prekshme neto
- Raporti minimal i të hyrave me pagesat e interesit
- Raporti maksimal i borxhit total në raport me EBIT ose EBITDA.

Të gjithë termat përkufizohen brenda marrëveshjes.

5.1.14. Zotimet

Kredimarrësi dhe garantuesi zotohen që:

- Do të bëjnë gjithçka që është e nevojshme për ta ruajtur vlefshmërinë dhe efektivitetin e marrëveshjes së kredisë
- Nuk do të krijojnë siguri mbi asetet e tyre, përveç rrethanave të përcaktuara me kredidhënësit
- Nuk do t'i asgjësojnë asetet më të mëdha, të bashkohen apo ta ndërrojnë biznesin e tyre, përveç me dakordimin e kredidhënësve
- Do ta ruajnë sigurimin mbi asetet e tyre
- Do ta respektojnë legjislacionin për mjedisin

- Në përgjithësi do ta mbajnë kompaninë në pozitë të mirë në përputhje me të gjithë legjislacionin dhe rregulloret në fuqi.

5.1.15. Ngjarjet e dështimit

Këtu përcaktohen rrethanat në të cilat kredithënësit mund të refuzojnë të ekzekutojnë shumën shtesë dhe potencialisht ta rrisin pagesën. Këtu përfshihet:

- Mos pagesa e principalit ose interesit
- Shkelja e kontratave financiare
- Deklarimi i gabuar në kuadër të pikës 5.1.12 më sipër
- Dështimet në kuadër të ndonjë marrëveshjeje tjetër financiare (“vonesë e dyfishtë”)
- Josolvenca
- Ndryshimi i pronësisë

5.1.16. Shitja e pjesëmarrjeve

Kredithënësve iu lejohej t’ua shesin pjesëmarrjet e tyre bankave të tjera përmes transferimit apo nënpjesëmarrjes.

5.1.16. Agjenti i Kredisë

Këto përcaktohen hollësisht, duke i specifikuar rolet dhe detyrat e Agjentit të Kredisë dhe rrethanat në të cilat ka, ose nuk ka, diskrecion për të vepruar në emër të kredithënësve. Mund të përfshihen rrethanat në të cilat Agjenti i Kredisë është i obliguar të veprojë sipas udhëzimeve të Bankave Shumicë, zotimi i të cilave përbën 50.1% (apo 66.7%) të kredisë.

5.1.17. Ligji qeverisës / Juridiksioni

Këtu përcaktohet shteti i ligjeve që e rregullojnë dokumentacionin dhe juridiksionin në të cilin e dorëzojnë palët.

5.2. Letra e tarifës së menaxhimit

Letra e tarifës së menaxhimit lidhet mes kredimarrësit dhe AKM(-ve). Ndërkohë që pagesa e tarifës së menaxhimit është kusht i paraparë në kuadër të marrëveshjes së kredisë, shumën nuk iu bëhet e ditur pjesëmarrësve.

5.3. Letra e tarifës për agjentin e kredisë

Kjo lidhet mes kredimarrësit dhe Agjentit të Kredisë. Tarifa e agjencisë së kredisë zakonisht është një shumë fikse që paguhet çdo vit paraprakisht.

5.4. Letra e tarifës për agjencinë e sigurisë

Kjo lidhet mes kredimarrësit dhe Agjentit të Sigurisë. Tarifa e agjencisë së sigurisë zakonisht është një shumë fikse që paguhet çdo vit paraprakisht.

Shtojca A: Kolaterali i përbashkët

Kompania që lidh transaksion të sindikuar ka gjasa të ketë marrë kredi më herët, prandaj asetet e saj më të vlefshme dhe më të realizueshme tashmë mund të jenë zotuar dhe mund të ketë asete të pamjaftueshme të pa zotuar për ta mbuluar kredinë e re.

Në kredi të sindikuar me kolateral, bankat japin kredi në bazë të sigurisë së përbashkët mbi asetet⁸ të cilat përbëjnë kolateral të mjaftueshëm për tërë shumën e borxhit. Një kredidhënës nga sindikata zakonisht emërohet për të vepruar si Agjent i Sigurisë për ta ruajtur sigurinë e trustit për të mirën e të gjithë kredidhënësve. Qëllimi është të sigurohet që: (1) një subjekt i vetëm është përgjegjës për aspektet administrative të sigurisë (siç është mbajtja e titujve të sigurisë dhe dokumenteve të tjera lidhur me pronën e lënë kolateral) dhe për të bërë shpërndarje të kredidhënësit e siguruar lidhur me zbatimin; dhe (2) kur një kredidhënës ia cakton ose ia bart interesin e vet një subjekti tjetër, kredidhënësi i ri përfiton nga paketa ekzistuese e sigurisë pa pasur nevojë që ta regjistrojë përsëri sigurinë apo që siguria të jetë e garantuar. Detyrat që i caktohen Agjentit të Sigurisë përcaktohen qoftë në një marrëveshje të veçantë të trustit të sigurisë apo në marrëveshjen e kredisë. Kredimarrësi në përgjithësi obligohet t'ia paguajë një tarifë Agjentit të Sigurisë, që zakonisht paguhet në baza vjetore.

Pasi të jetë përcaktuar parimi i sigurisë së përbashkët, do të ketë ende kredi ekzistuese të siguruara nga asetet individuale. Në rastet kur kredimarrësit dëshirojnë ta krijojnë një kredi të sindikuar, opsionet përfshijnë:

- Rifinancimi i borxhit ekzistues në kuadër të sindikimit, duke i liruar tarifat ekzistuese në mënyrë që aseti(et) të mund të përfshihen në grup; ose
- Lirimimi i tarifës së tij nga kredidhënësi ekzistues për një aksion së bashku me pjesëmarrësit e sindikatës në sigurinë e përbashkët që e mban agjenti i sigurisë.

⁸ Kamatat mbi asetet e paluajtshme, zotimet mbi asetet e luajtshme apo kombinim i të dyjave.

Shtojca B: Roli i agjentit të kredisë

1. Përmbledhje

1.1 Roli i Agjentit të Kredisë është që në rend të parë t'i ofrojë shërbim kredimarrësit dhe kredidhënësve në një kredi të sindikuar për llogaritjen e shumave që i takojnë secilës palë dhe për transferimin e mjeteve. Agjenti i sigurisë është përgjegjës edhe për shpërndarjen e shpejtë të informatave të ofruara nga kredimarrësi në lidhje me termat e marrëveshjes së kredisë. Detyrat e sakta të Agjentit të Kredisë përcaktohen në një klauzolë të marrëveshjes së kredisë dhe shumica e institucioneve që ofrojnë shërbime të agjencisë e kanë një klauzolë standarde të aprovuar, bazuar në shabllonin përkatës të ShTK-së, që e përdorin në të gjitha marrëveshjet e tyre.

1.2 Pas përmbushjes së kushteve të parapara, Agjenti i Kredisë është përgjegjës për realizimin dhe pranimin e pagesave mes kredidhënësve dhe kredimarrësit. Fillimisht, rrjedha e pagesave është nga kredidhënësit tek Kredimarrësit kur tërhiqet kredia; rrjedhimisht, pagesat e interesit dhe pagesat e principalit bëhen nga kredimarrësi te kredidhënësit. Po ashtu, kredimarrësi ua paguan tarifat (tarifat administrative, tarifat e zotimit, tarifat tjera) kredidhënësve përmes Agjentit të Kredisë. Agjenti i Kredisë është përgjegjës për të gjitha llogaritjet e bëra ose të nevojshme në lidhje me këto pagesa.

1.3 Agjenti i Kredisë është përgjegjës për ta njoftuar sindikatën me kohë për çdo informatë që e merr nga kredimarrësi. Po ashtu, ai shërben si kanal përmes të cilit bëhen kërkesat nga kredimarrësi për kredidhënësit për largim apo ndryshim të termave të marrëveshjes së kredisë.

1.4 Agjenti i Kredisë nuk ka kompetenca të vendim-marrjes përveç nëse parashihet me marrëveshjen e kredisë. Agjenti i Kredisë ka të drejtë të supozojë që dokumentet e pranuar nga kredimarrësi janë të besueshme dhe nuk e ka për detyrë të kontrollojë nëse përmbajtja e tyre është në pajtueshmëri me termat e marrëveshjes së kredisë përveç nëse kjo kërkohet veçanërisht me termat e marrëveshjes së kredisë.

1.5 Nëse ka veprimtari të tregut të dytë, Agjenti i Kredisë e menaxhon procesin e transfereve dhe bën ndryshime në llogaritë e transaksionit për ta reflektuar ndryshimin e pronësisë në mënyrë që rrjedhat e ardhshme të mjeteve të bëhen saktë te blerësi apo nga blerësi. Blerësi dhe shitësi duhet t'ia paguajnë Agjentit të Kredisë një tarifë të transferit (të përcaktuar në marrëveshjen e kredisë) dhe kjo tarifë ndalet nga Agjenti i Kredisë për këtë punë administrative.

2. Tarifat e agjencisë së kredisë/sigurisë

2.1 Agjenti i Kredisë dhe ai i Sigurisë marrin një tarifë vjetore të agjencisë nga kredimarrësi për shërbimet e tyre. Tarifat e agjencisë përcaktohen në listën e kushteve që është pjesë përbërëse e mandatit të AKM-së dhe janë zakonisht një shumë fikse që paguhet çdo vit paraprakisht.

2.2 Tarifat për këto shërbime duhet të përfshihen në listën e kushteve. Subjektet që ofrojnë shërbime të tilla duhet ta japin shumën e këtyre tarifave për tu përfshirë në listën e kushteve.

3. Detyrat kryesore të Agjentit të Kredisë

3.1 Detyrat e Agjentit të Kredisë përcaktohen në marrëveshjen e kredisë në çdo rast dhe Agjenti i Kredisë duhet ta ketë një listë pune me detyra që duhet të kryhen në bazë të rregullt. Detyrat kryesore janë:

- verifikimi me këshilltarin e jashtëm ligjor që Kushtet e Parapara janë përmbushur dhe që siguria e ofruar për sindikatën është marrë në mënyrë efektive;
- pranimin e kërkesave për disbursim/shfrytëzim;
- administrimin e periudhave të interesit;
- rregullimin e normave të interesit dhe njoftimin për normat e interesit për periudhat e interesit;
- llogaritjen e shumave të interesit duke përdorur rregullat e sakta;
- kontrollimin e informatave për ndryshime në margjinë (kur margjinat ndryshojnë me kalimin e kohës ose janë të lidhura, për shembull, me raportin e borxhit të Kredimarrësit ndaj EBITDA-s);
- llogaritjen dhe kërkesat e tarifave administrative, të zotimit dhe të tjera;
- vepron si përçues i informacionit;
- vepron si përçues i pagesave;
- kontrollimin e llojeve të caktuara të informacionit;
- kontrollet NKT (Njihe Klientin Tënd) në lidhje me shitjet dytësore;
- ekzekutimin e vërtetimeve të transferim për transferimin e zotimeve të kredidhënësve dhe regjistrimin e transfereve;
- dërgimin e kërkesave për pëlqime nga kredidhënësit për largime, ndryshime dhe pëlqime në kuadër të dokumentacionit të kredisë dhe nënshkrimin e largimeve, ndryshimeve dhe pëlqimeve në emër të kredidhënësve (apo shumicës së kredidhënësve varësisht prej natyrës së kërkesës); dhe
- trajtimin e komunikimeve lidhur me ngjarje të dështimevedhe organizimin e takimeve me bankat.

3.2 Agjenti i Kredisë nuk është përgjegjës për obligimet e asnjë pjesëmarrësi për disbursim në kuadër të marrëveshjes së kredisë. Ky sqarim jepet në mënyrë të qartë në marrëveshjen e kredisë.

3.3 Kur pagesat e pa ekzekutuara janë nga kredimarrësi në kuadër të marrëveshjes së kredisë, Agjenti zakonisht lëshon udhëzime për kredimarrësit lidhur me pagesën në pritje të faturës. Nëse kredimarrësi nuk arrin të paguajë, kredidhënësit janë të obliguar t'i kthejnë mjetet tek Agjenti i Kredisë me vlerë të mirë. Nëse Agjenti i Kredisë ka arsye për të besuar se kredimarrësi mund të mos arrijë të paguajë, mund ta mbajë pagesën derisa ta verifikojë faturën nga kredimarrësi. Nëse Agjenti i Kredisë nuk arrin ta verifikojë faturën me kohë për t'ua bërë pagesat kredidhënësve në ditën e njëjtë, pritet që ai të paguajë me vlerë të mirë.

3.4 ShTK-ja u ka ofruar anëtarëve të tij një dokument me titullin Praktikat e Agjencisë që duhet të shërbejë si themel për praktikat e agjencive të bankave të përshtatura për t'i plotësuar nevojat lokale. Të gjitha bankat që duan të veprojnë si Agjent i Kredisë duhet t'i miratojnë ato, me ndryshimet e kohëpaskohshme, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me kushtet dhe politikat e tyre të brendshme.

3.5 Edhe pse Agjenti i Kredisë i ofron një shërbim të vlefshëm kredimarrësit, roli i tij ligjor është si agjent për kredidhënësit, e jo për kredimarrësin. Agjenti i Kredisë duhet t'i ndjekë termat e marrëveshjes së kredisë, pasi që detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë të përcaktuara. Dështimi për ta bërë këtë mund të rezultojë në padi për neglizhencë nëse Agjenti i Kredisë

devijon nga këto detyra dhe përgjegjësi. Kjo nënkupton që departamenti i agjencisë duhet të ketë njerëz me përvojë dhe të ketë sisteme dhe kontrolle efektive.

3.6 Agjenti i Kredisë duhet t'i trajtojë interesat e të gjithë kredidhënësve në mënyrë të barabartë. Nëse Agjenti i Kredisë është edhe kredidhënës, nuk duhet të bëjë asgjë që i vë në rend të parë interesat e vet të kredidhënies para atyre të bankave të tjera dhe duhet të krijohen kontrolle mbi rrjedhën e brendshme të informacionit për ta parandaluar këtë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse ekziston një mundësi e konsiderueshme që kredimarrësi t'i vonojë obligimet e tij.

3.7 Për të vepruar si Agjent i Kredisë, stafi duhet të jetë i trajnuar dhe i besueshëm dhe t'i kuptojë përgjegjësitë dhe rëndësinë e përfaqësimit të interesave të të gjithë kredidhënësve në mënyrë të barabartë. Krijimi i këtij funksioni përfshin ndarjen e burimeve dhe kostove: mënyra më efektive e trajnimit të personelit është përmes mobilitetit, qoftë të jashtëm apo të brendshëm.